



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2019

Lënda: Kthim përgjigje.

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
**Rruga: \_\_\_\_\_, Shkodër**

E nderuar \_\_\_\_\_,

Në cilësinë e kërkesit, keni depozituar pranë Bashkisë Shkodër, në përputhje me ligjin nr.119/2014, ‘‘Për të Drejtën e Informimit’’, kërkesën për dhënie informacioni, regjistruar me nr. 867 prot., datë 4.11.2019.

Pas shqyrtimit të kërkesës tuaj, Ju sqarojmë si më poshtë:

Fshati Golem pas reformës territoriale të vitit 2014 është pjesë e Bashkisë Shkodër. Pas reformës së vitit 2016 për riorganizimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për të përmbushur nevojat e njerëzve, fshati Golem si zonë shërbimi mbulohet nga Ujësjellës Kanalizime Shkodër.

Në lidhje me furnizimin me ujë të fshatit Golem, siç edhe ju e keni konstatuar në kërkesën tuaj ai ka munguar prej vitesh.

Pavarsisht se fshati Golem mbulohet si zonë shërbimi nga Ujësjellës –Kanalizime Shkodër, ky i fundit nuk i ka kapacitetet financiare për të ndërtuar një rrjet të ri ujësjellësi për këtë fshat meqënëse ky fshat nuk ka rrjet ujësjellësi ekzistues.

Ujësjellës Kanalizime Shkodër, furnizimin me ujë të fshatit Golem e ka përfshirë në projektin që do të zbatohet në vitet 2020-2021 nga qeveria Gjermane në bashkëpunim me KFW-në.

Aktualisht projekti është në fazën e projektimit pasi është kryer studimi i fizibilitetit për fshatin Golem, zonën e Dobraçit dhe zonën pas Sanatoriumit në Shkodër.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin!

**KRYETAR**  
**VOLTANA ADEMI**